



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1492/4 prot.

Tiranë, më 18. 12. 2024

V E N D I M

Nr. 305, datë 18. 12. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa me nr. 221 Regj., datë 30.10.2024, e paraqitur nga O. L. kundër Shkollës 9-vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të vajzës së tij të mitur F. L., për shkak të “gjendjes ekonomike”, “racës” dhe “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, O. L., në mes të tjerash informon se: “...Jam babai i një vajze, e cila vazhdon arsimin 9 vjeçar pranë Shkollës “Pandeli Cale” dhe aktualisht është në klasën e 5.

Në muajin tetor, kam marrë informacion rastësisht nga prindërit e tjerë, për të përgatitur dokumentacionin për përfitimin e bursës në bazë të VKM Nr. 511, datë 27.07.2022, i ndryshuar. Kam shkuar pranë shkollës dhe kam folur me Nën/drejtoreshën e cila më ka thënë që nuk mund të jesh përfitues i kësaj burse pasi trajtohesh me ndihmë ekonomike edhe pse ajo ka ardhur tek shtëpia ime dhe ka parë kushtet ku unë jetoj. Vitin e kaluar nuk kam qenë përfitues për të njëjtën arsye. Jam detyruar që vajzën të mos e çoj rregullisht në shkollë pasi nuk kam mundësi financiare. Nuk ia plotësoj dot kushtet. Bëj punë të rëndomtë duke shitur hekurishte, çaj dru.

Këtë udhëzim për mospranimin e dokumenteve ata e kanë marrë nga Ndërmarrja Mbështetëse e Kopshteve dhe Çerdheve pranë Bashkisë Korçë. (sipas Nën drejtoreshës së shkollës V. Q.).

Pagesa ime e ndihmës ekonomike është 4792 lek në muaj. Mundet të më shpjegojë dikush a është e mundur që unë të mos futem në kriterin “familje në nevojë”, ku dihet që ndihma ekonomike jepet për këtë kategori dhe aktualisht jam i regjistruar në Zyrën e Punës si punëkërkuar i papunë? Po u drejtohem ju si institucion që të më zgjidhet problemi im pasi jam në vështirësi të madhe ekonomike, gëzoj statusin e “familjes në nevojë” dhe jam punëkërkuar i papunë. Si mua janë shumë familje të cilat nuk po gjejnë zgjidhje për këtë situatë. Kur shteti e ngre me të madhe arsimimin e fëmijëve po na “detyron” që ta braktisim atë pasi nuk kemi mundësi financiare.”

Ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri, hetimin e rastit, konstatimin e diskriminimit dhe rekomandim për marrjen e bursës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 221, datë 30.10.2024, të bërë nga O. L., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 06.11.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Shkolla 9-vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e bërë nga O. L..

Në përgjigje sa më lart, Shkolla 9-vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë, me shkresën¹ nr. 93 prot., datë 08.11.2024, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Ankuesi, O. L., pas sqarimeve të disa hershme nga drejtorja e shkollës, lidhur me dokumentacionin që duhet të sillte në shkollë për përfitim të bursës, është paraqitur në drejtorinë e shkollës për të dorëzuar dokumentet që ai dispononte: certifikatën personale të nxënëses, certifikatën familjare dhe vërtetimin që trajtohej me Ndhmë Ekonomike nga Bashkia Korçë, ishte sqaruar për kriteret e njoftuara nga NSHMAÇ Bashkia Korçë dhe i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit me vërtetimet për bashkëshorten e tij, përkatësisht: regjistrimin si punëkërkuese e papunë dhe regjistrimin apo mosregjistrimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë. Këto dokumentacione nuk u paraqitën në shkollë nga O. L., pavarësisht se është kërkuar plotësimi i tyre para se të dorëzohej dosja me aplikimet e nxënësve në NSHMAÇ, që pas shqyrtimit të dokumentacionit, mund të përfitojnë bursën e plotë.

Duke qenë se deri në datën 30 tetor 2024 prindërit e nxënëses F. L., pavarësisht sqarimeve dhe orientimeve tona, nuk u paraqitën përsëri për të sjellë dokumentacionin e plotë, ne nuk kishim çfarë të dorëzonim pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, pasi nuk dispononim asnjë dokument në shkollë.

Në datën 07.11.2024, pas kërkesës së drejtorisë së shkollës, znj. E. D. solli në drejtorinë e shkollës, së bashku me dokumentacionin e saj për përfitim të bursës edhe dokumentacionet e ankuesve të tjerë, për të cilët jemi informuar nga ju, midis tyre edhe dokumentacionin që dispononte O. L..

Në zbatim të detyrës së lënë shkollës, në shkresën e dërguar nga ju, dokumentacionin e paraqitur më 07.11.2024, nga znj. E. D., e dërguam me postë në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë.

Ju bëjmë me dije se:

- Institucioni ynë arsimor është hallkë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës ndër-institucionale për shpalljen dhe bërjen publike të kërkesave dhe kriterëve për përfitim të bursës nga nxënësit që u përkasin kategorive të ndryshme; grumbullimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për nxënësit përfitues, pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, e cila shqyrton dokumentacionin e dërguar prej nesh, dorazi, dhe vendos nëse është apo jo i rregullt ky dokumentacion përpara se të miratojë kërkesën e shkollës për nxënësit përfitues të bursës.
- Në datën 3 tetor 2024, përmes postës elektronike jemi njoftuar me email nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, se në bazë të hartës sociale për nxënësit e shkollës sonë dhe kriterëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhej të mblidhnim dokumentacionin e duhur për përfitim të bursave nga nxënësit. Bashkëngjitur në këtë email u dërgua edhe shkresa e Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë së

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1492/2 prot., datë 11.11.2024

Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me Nr. 6016 prot., datë 26.09.2024 drejtuar Bashkisë Korçë “Për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar publik, për vitin shkollor 2024-2025”

- *Në datën 16 tetor 2024, përmes postës elektronike jemi njoftuar me email nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, për dokumentet që duhen plotësuar dhe dorëzuar, bazuar në kriteret e përcaktuara për kategoritë e nxënësve përfitues të bursës.*

Gjatë kësaj kohe kemi kontaktuar vazhdimisht me NSHMAÇ dhe jemi sqaruar për raste të ndryshme dhe pretendime lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet të interesuarit e kategorisë “Fëmijë të familjeve në nevojë, të regjistruar në arsimin bazë por në pamundësi financiare nuk mund ta ndjekin atë”. Kemi kërkuar që prindër të nxënësve që vijnë nga familje në nevojë të dorëzojnë në shkollë dokumentacionin që vërteton arsyet financiare dhe domosdoshmërinë për të përfituar bursën. Institucioni ynë arsimor nuk ka kompetenca të vlerësojë mjaftueshmërinë apo pamjaftueshmërinë e vlerës në lekë të ndihmës ekonomike, që marrin familjet e nxënësve nga Bashkia e Korçës.

- *Në datën 29 tetor 2024, pas kërkesës së dërguar në postën elektronike të shkollës, dërguam me email kërkesën e shkollës për nxënësit, që kishin dorëzuar dokumentacionin për të qenë përfitues të bursës. Dosja me dokumentacionin e grumbulluar dhe kërkesën e shkollës për të shqyrtuar dhe miratuar listën e nxënësve përfitues të bursës, u dorëzua dorazi në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, në datën 30 tetor 2024.*
- *Jemi në pritje të përgjigjes së Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, do të na njoftojë për të plotësuar data bazën me të dhënat e nxënësve që do ta përfitojnë bursën për vitin shkollor 2024 - 2025.*

Lidhur me kërkesën tuaj për informim, përsa i përket frekuentimit të shkollës nga nxënësja F. L., gjatë vitit shkollor 2023 - 2024, ju bëjmë me dije se shkolla jonë ka ndjekur në mënyrë të vazhduar vijueshmërinë e nxënësës dhe ka protokolluar çdo hap të hedhur në këtë drejtim. Pavarësisht përpjekjeve tona, për të bashkëpunuar me familjarët e saj me qëllim garantimin e vijueshmërisë, nxënësja F. L. rezultoi e paklasifikuar për shkak të mungesave gjatë vitit shkollor 2023 -2024. Ajo po e përsërit klasën e katërt në vitin shkollor 2024-2025. Bashkëngjitur, po ju dërgojmë edhe dokumentacionin që tregon në mënyrë të përmbledhur punën e shkollës sonë për këtë rast...”.

Më datë 16.12.2024, ankuesi është paraqitur pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë dhe ka depozituar një shkresë duke kërkuar pushimin e ankesës për shkak se ajo mori zgjidhje, pas ndërmjetësimit të strukturave të Komisionerit ku u arrit që dokumentacioni për përfitimin e bursës të pranohej nga institucioni përgjegjës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga

Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 221, datë 30.10.2024, të O. L., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia, raca dhe gjendja ekonomike)
(Fusha: Arsim)